

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren e vetme gjykuese Lumnije Krasniqi, bashkëpunëtorin Profesional Feriz Berisha, në çështjen penale, kundër të pandehurit **B.P.**, për shkak të veprës penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve t; përfituara me kryerjen e veprës penale, nga neni 345 par.2 të KPRK-së, i akuzuari sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.7143/16, të dt.21.03.2018, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.7143/16, të dt.21.03.2018,për dhënien e urdhrin ndëshkimor, më dt.**23.05.2018**, jashtë seancës gjyqësore, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.7143/16, të dt.21.03.2018dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri: B.P., i biri A. dhe nënës M. i vajzërisë G.,i lindur me dt...., në M., ku edhe jeton në rr. "A.V.",nr,..., me nr. të ID-së ..., punëtor, i gjendjes së ultë ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

S e p s e:

Me dt. 14.09.2016,i pandehuri, edhe pse ka mundur ta dijë se është përfituar me kryerjen e veprës penale, nga NN, personi,ka pranuar një telefon HTC,në të cilin telefon ka qenë i vendosur numri ... dhe në të ka vendosur numrin e tije te cilin telefon e ka përdorur nga data 14 deri më 28.09.2016,-

- **me këtë ka kryer veprën penale -Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale, nga neni 345 par.2 të KPRK-së .**

Andaj gjykata në bazë të neneve 41, 43, 46, të KPRK-së, si dhe neneve 365 e 495, të KPRK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **200 (treqind euro) €**, të cilin dënim, është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, **me 3 (tri) këste mujore.**

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 (njëzet) € të gjobës.

Obligohet i pandehuri që t'i paguaj shpenzimet procedurale aq sa do të jenë sipas llogarisë së kësaj gjykate, dhe në emër të paushallit gjyqësorë do të paguaj shumën prej **20 (njëzet) €**,në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari: B.B., me vendbanim në P. rr. "V.T. ",-E., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me Aktakuzën PP.II.nr.7143/16, të dt.21.03.2018, e ka akuzuar **B.P.** - , për shkak të veprës penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve t; përfituara me kryerjen e veprës penale, nga neni 345 par.2 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimorë, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495, të KPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: Kallëzimi penal, policor 2016-AD-2764, i dt.27.11.2016,të dhënat e I.-s me nr.Ref.II.nr.1523/2016, si dhe provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës, shihet se ekziston dyshimi i arsyeshëm se janë prova të besueshme mbi bazën e të cilave vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lartë, gjykata konstaton se i pandehuri **B.P.**, është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve t; përfituara me kryerjen e veprës penale, nga neni 345 par.2 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, është marrë në bazë të nenit 450 të KPRK-së.

Në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPRK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM P.nr.1533/18, i dt.23.05.2018

Bashkëpunëtori Profesional Gjyqtarja,
Feriz Berisha

Lumnije Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh,nga dita e pranimit të tij, në këtë gjykatë.